

URDHËR
Nr. 75, datë 12.2.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të neneve 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; të kreut IX, neni 73, pika 2, të vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; vendimit nr. 783, datë 18.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”; të rregullores së brendshme të miratuar me urdhër të Kryeministrit nr. 201, datë 20.11.2023, “Për miratimin e rregullores së brendshme ‘Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike’”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e të gjitha kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Sigurisë Kibernetike dhe të nëpunësit të autorizuar, z. Saimir Kapllani, drejtor, Drejtoria e Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike.
 2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Autoritetin Kombëtar të Sigurisë Kibernetike, z. Saimir Kapllani, drejtor, Drejtoria e Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike.
 3. Kompetencat e deleguara të titullarit do të ushtrohen nga data 13.2.2026 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.
 4. Ngarkohet drejtori i Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike për zbatimin e këtij urdhri.
 5. Ngarkohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Igli Tafa